

NEWSLETTER

Korrik

**60-Vjeçari: Ja si Mora
30.000 Lekë Gjobë se
Nuk Kisha Sigurim
Makine.**



**Shëndeti në Udhëtim,
Sigurimi që i Duhet Çdo
Pushuesi Jashtë Vendi**

**Navigo, Kërko,
Kliko, Bli Online
në Albsig**

**Albsig Jetë sjell
shërbimin e Opinionit
të Dytë Mjekësor
me kartën MediGuide**

**Studenti Shqiptar
në Letoni: Ja Si më
Shpëtoi Sigurimi
në Albsig**

**Marin Xhaxhiu i Riu, Këmbëngulës dhe Ambicioz,
që po ja Kushton Çdo Gjë Profesioneit të Auditit.
Një Rrëfim për Punën dhe Karrierën e Saponisur.**

Shoqëria e Sigurimit Albsig sh.a., pjesë e Grupit KASTRATI, ushtron aktivitet të suksesshëm që nga viti 2004, në cilësinë e siguruesit të Jo - Jetës. Me një rrjet me 28 degë, Albsig mbulon territorin e Republikës së Shqipërisë. Albsig mbështetet në stafin e dedikuar dhe profesional dhe ofron shërbim të shpejtë dhe cilësor.

VIZIONI

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.

MISIONI

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.

FILOZOFIA

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.





Studenti Shqiptar në Letoni: Ja Si më Shpëtoi Sigurimi në Albsig



Është nga ata studentët që me përkushtim dhe vetëm falë rezultateve të larta, ka fituar masterin në Letoni. Është shumë i përkushtuar pas profesionit dhe për këtë do të mbarojë çdo hallkë për ta plotësuar sa më mirë "puzzle-in" e profesionit. Ka shëtitur në disa shtete të Evropës dhe çdo gjë i ka shkuar mire, si nga shkolla edhe nga shëndeti, por ndryshe nga përvojat e mëparshme në shkollë këtë herë ka hasur në problematika shëndetësore të papritura.

"Filloi gjithçka në mënyrë të papritur. Edhe vetë smë ka shkuar në mendje që do të mund të më çonte Zoti në një sakrificë të tillë. Isha në banesë dhe më filloi një gjakderdhje nga hundët. Mendova se e kam nga vapa sepse ishte shumë nxehtë. Që në fillim u frikësova pak, por me idenë se do më kalojë mundohesha të qetësoja veten time. Gjakderdhja, jo vetëm nuk më kaloi, por mu shtua më shumë. Edhe pse isha vetëm, u ngrita dhe lajmërova menjëherë ambulancën për të më dhënë ndihmën e shpejtë", kështu nis të tregojë ngjarjen Antonio Çoniku, student nga Durrësi. Ai është një ndër studentët më të rregullt për sa i përket pajisjes me dokumentat e kërkuara nga ambasadat me të cilat ai ka bashkëpunuar për shkollë. Sqaron se nuk vuan nga asnjë sëmundje e mëparshme që të jetë shkaktare e gjakderdhjes nga hundët.

“Unë nuk kam asnjë sëmundje të mëparshme. Kam ndërruar disa shtete për të përfunduar studimet e mia dhe nuk kam pasur asnjë rast të tillë shëndetësorë edhe pse kam qenë i pajisur me ‘Sigurimin e Studentëve Jashtë Shteti’. Si përvojë e parë në një rast të tillë edhe vetë e kam përjetuar me shumë frikë dhe ankth. Falë Zotit dhe ndërhyrjes së shpejtë nga mjekët e urgjencës e më pas të spitalit ku u paraqita mu rikuperua problemi i shëndetit”, tregon me shumë optimizëm dhe me të gjitha detajet e hollësishme të ngjarjes Antonio Çoniku, i riu nga Durrësi që do t’ua bëjë kulturë dhe bashkëmoshatarëve të tjerë në Shqipëri.

Njëkohësisht thekson faktin se sigurime të tilla janë të domosdoshme të përdoren, jo vetëm për studentët jashtë shteti por edhe ata në Shqipëri. Është një ndihmë shumë e madhe financiare që ju vjen studentëve nga sigurimet. Mungesa e kulturës së sigurimeve në Shqipëri është trashëguar brez pas brezi dhe vetëm 5 vitet e fundit shikohet që ka ndryshuar pak mentaliteti dhe qasja e njerëzve për tregun e sigurimeve.

“Une në të gjithë periudhën e shkollës jashtë, jam pajisur me sigurimin e duhur dhe e dija shumë mirë se si do të veproja në rast problemi shëndetësor. Me rastin që më ndodhi, prita derisa mund të kem mundësi për t’u qetësuar, por kur kuptova që situata ime shëndetësore po përkeqësohej, kërkoja ndërhyrjen e mjekut specialist. Duke parë që me ndërhyrjen e parë nuk isha plotësisht i rikuperuar, shkova dhe të nesërmen në spital dhe mora shërbimin e kërkuar. Më pas, kam lajmëruar menjëherë Shoqërinë e Sigurimeve Albsig në Durrës dhe më vonë kam ardhur në qendër, në Tiranë për të vërtetuar dhe plotësuar dokumentacionin e kërkuar”, vijon Çoniku. Studenti tregon për komunikimin me inxhinierët e dëmeve të Shoqërisë së Sigurimeve Albsig, të cilët e pritën me shumë pozitivitet dhe dashamirësi deklarimin e dëmit dhe rakordimin e të gjitha fakteve përmes faturave të spitalit dhe rakordimet e mjekëve. “Dëmshtëpërblimi ishte në kohë rekord dhe kundrejt të gjitha parametrave të duhura. Jam i befasuar nga shërbimi i Kompanisë Albsig sepse çdo gjë më është bërë në kohën e duhur”, vijon së treguari studenti A. Çoniku.

I kënaqur nga eksperiencia e tij, djali nga Durrësi, udhëzon të gjithë moshatarët e tij të pajisen me ‘Sigurimin e Studentëve Jashtë Shteti’ sepse është një ndër burimet kryesore që mbron financat e të rinjve që janë për studime jashtë Shqipërie.

“Mendoj se mentaliteti për sigurimet tashmë sa vjen e po zbehet. Sigurimet kanë qenë dhe do të mbeten gjithmonë shumë të rëndësishme për financat e çdo familje shqiptare. Për këtë u bëj thirrje çdo të riu dhe familje shqiptare që të sigurohen sepse sigurimet janë në dobi të gjithësecilit prej nesh.” Me këtë thirrje të rëndësishme, jo vetëm për moshatarët e tij, por për të gjithë konsumatorët në përgjithësi, mbyll rrëfimin e tij studenti A. Çoniku.

“Une në të gjithë periudhën e shkollës jashtë, jam pajisur me sigurimin e duhur dhe e dija shumë mirë se si do të veproja në rast problemi shëndetësor.”

— A. Çoniku.

Bli Online



Navigo, Kërko, Kliko, Bli Online në Albsig

Mos "përto", mos dil në mesin e vapës të blesh siguracionin që të duhet. Respekto vetveten dhe rregullat e duhura për t'u mbrojtur dhe nga Covid-19, pasi në këtë sezon ka filluar dhe shtimi i rasteve. Mos shko nëpër sportele, por aksesoj Albsig-un online. Hap telefonin apo kompjuterin dhe bli menjëherë online sigurimin që të nevojitet për veten dhe familjen tënde. Shoqëritë e Sigurimeve që kryesojnë tregun real tashmë e kanë shtrirë planin dhe për "tregun virtual". Audiencia virtuale tashmë është kryesorja sepse bota virtuale ndiqet, jetohe dhe besohet më shumë nga njerëzit krahasimisht me atë realen. Shoqëritë e Sigurimeve, për shitjet online janë vetëm në fillimet e para, megjithatë po gjejnë vështirësi të rriten në një treg që është pothuajse i paeksploruar dhe të mbijetojnë në mesin e konkurrencës së "egër" të shitjeve tradicionale. Ashtu si në tregun real edhe në tregun virtual duket se Shoqëritë e Sigurimeve kanë thuhajse të njejtat qasje.

“Tregu Virtual me Çmimet më të Mira”

Nga navigimi në web-faqet zyrtare del se blerjet online janë më shumë të aktivizuara nga Shoqëritë e Sigurimeve siç është Albsig. Albsig tashmë duket se ka filluar të bëjë strategji marketingu dhe shitje edhe për “tregun virtual”. Janë një gamë e konsiderueshme produktesh që mund t’i blësh online përmes faqes zyrtare të Shoqërisë së Sigurimeve Albsig. Keni planifikuar pushimet jashtë shtetit shqiptar? Ju duhet të pajiseni me ‘Sigurimin e Shëndetit në Udhëtim’? Menjëherë hap web-faqen e Albsig. Aty do të gesh mundësitë më të mira me çmimet dhe ofertat e duhura. Keni bërë valixhet gati, keni përgatitur pasaportat e gjithë familjarëve, mos harro dhe “pasaportën e sigurisë” për të papriturat e shëndetit të të gjithë familjes.

Për të gjithë klientët dhe jo vetëm, që zgjedhin të blejnë ‘Sigurimin e Shëndetit në Udhëtim’ online në Albsig mund ta blejnë me 30% zbritje nga çmimi real në treg. Po nuk mbaron me kaq. Ofertat me ulje çmimesh sapo kanë nisur në këtë sezon veror në Albsig. Edhe për emigrantët që vijnë për pushime në Shqipëri, Albsig ka menduar për ta. Polica kufitare, ju kërkohet çdo emigranti në doganë dhe është një lloj TPL që mbulon përgjegjësinë e mjetit me targa të huaja. Të duhet të nisësh në një udhëtim biznesi, pushimesh apo turizmi? Asnjëherë mos udhëto pa sigurim makine sepse rreziku juaj financiar mund të jetë shumë më i madh nga sa mund ta mendoni. ‘Polica e Sigurimit Kufitar’ mund të blihet me afat 15-ditor, 45-ditor, 1-mujor, 6-mujor apo 1-vjeçar. Në Albsig, policën kufitare online mund ta gjeni me 10% zbritje nga çmimi real i tregut.

“TPL - Sigurimi që Mund të Blihet me një Klik në Albsig”

Albsig mendon në çdo kohë dhe në çdo moment, jo vetëm për klientët e saj por për të gjithë konsumatorët në përgjithësi. Duke qenë të angazhuar në punë, në të shumtën e rasteve gjithësecilit prej nesh na mungon koha fizike për të kryer shërbimet vetjake. Ai që na vjen në ndihmë është telefoni. Sezoni i blerjeve online nga ana e gjithësecilit prej nesh u fokusua tek shërbimet dhe produktet e siguracioneve, për të përzgjedhur ofertën më të mirë apo kushtet më të përshtatshme. Blerjet online janë një nga lehtësitë që kanë përfituar njerëzit me zhvillimin e teknologjisë. Me shpejtësinë e një kliku mund të blësh produkte pa qenë nevoja që të orvatesh zyrave e dyqaneve për të gjetur atë që kërkon edhe po qe nevoja pa u kufizuar brenda kufijve të shtetit tënd. Keni qenë të angazhuar me punë dhe pa dashje ju ka kaluar dita e sigurimit të detyrueshëm të automjetit tuaj? Ju s’keni pse të mërziteni. Albsig ju ofron këtë mundësi edhe përmes blerjeve që ju do të bëni online. Mungesa e kulturës në sigurime në Shqipëri ka bërë që konsumatorët të njohin dhe vlerësojnë më së shumti sigurimet e detyrueshme. ‘Sigurimi TPL’ është sigurimi i detyrueshëm i mjetit me targa shqiptare për qarkullim brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Kohëzgjatja e kësaj kontrate sigurimi është 1 vit dhe mund ta blini përmes web-it me 10% zbritje nga çmimi në treg.

Nuk ke pse të dalësh në rrugë me mjetin tuaj pa u pajisur me këtë sigurim sepse përveçse do të gjobiteni 40 mijë lekë nga Policia e Shtetit, dëmet mund të jenë fatale për ju dhe familjen tuaj. Albsig këtë produkt e ofron me çmime shumë të favorshme në blerje online.

E ndërsa bota po rend drejt veprimeve online, Shqipëria renditet e fundit ndër vendet anëtare dhe candidate të BE-së për blerjet online. Shqipëria është vendi me përqindjen më të ulët të blerjeve online në krahasim me vendet e Bashkimit Evropian dhe kandidatëve për anëtarësim. Sipas Anketës së Cilësisë së Jetës, 85% e të pyeturve kanë deklaruar se nuk kanë kryer blerje online dhe 15% kanë deklaruar se kanë bërë blerje online. Ndër vendet candidate përqindjen më të ulët të blerjeve online pas Shqipërisë e ka Maqedonia, ku vetëm 25% të të anketuarve kanë deklaruar se kanë kryer blerje online. Në Malin e Zi, Serbi dhe Turqi, përqindja e të anketuarve online që kanë deklaruar se kanë bërë blerje online varion nga 31 në 34%. Mesatarja e të anketuarve në Bashkimin Evropian që kanë deklaruar se kanë kryer blerje online është 67%.

Vendet e Bashkimit Evropian me përqindjen më të lartë të blerjeve online janë Suedia me 85%, Mbretëria e Bashkuar me 84%, Danimarka dhe Holanda me 83%, Finlanda me 76%. Ndërsa vendet anëtare të Bashkimit Evropian që kanë shënuar përqindjen më të ulët të të anketuarve që kanë deklaruar se kanë kryer blerje online janë Kroacia me 33%, Rumania dhe Portugalia me 36% dhe Greqia me 37%. Ndërsa shqiptarët në vend të një kliku vazhdojnë të përzgjedhin hyrjet dhe daljet nga një dyqan në tjetrin.



Marin Xhaxhiu i Riu, Këmbëngulës dhe Ambicioz, që po ja Kushton Çdo Gjë Profesione të Auditit.

Një Rrëfim për Punën dhe Karrierën e Saponisur.

“Punë ka, kur ka këmbëngulje për ta realizuar atë”, kjo është shprehja që i përshtatet më shumë disa të rinjve që me punë dhe durim arrijnë qëllimin dhe ëndrrat e tyre. Kanë filluar me praktikën që i kërkohej për në shkollë, por pasioni për të mësuar ka bërë që të lidhen më shumë me kompaninë ku ata kanë marrë njohuritë e para. Me nisjen e praktikës kanë filluar dhe “sekretet” e rrugëtimit të një grupi punonjësish të rinj në Shoqërinë Albsig. Edhe nga praktika mund të bëhesh pjesë e stafit të Albsig.

Çfarë procedurash ndjek shoqëria për të përthithur punonjësit e rinj. Këto dhe shumë fakte të tjera, vijnë në një rrëfim të singertë që do të tregojë me shumë detaje rrugëtimin e tij të deritanishëm, Marin Xhaxhiu, Audit në Shoqërinë Albsig. Periudha e praktikës, përzgjedhja, testimi e deri në emërimin e tij në pozicionin e ëndërruar, atë të auditit. Këmbëngulja për të ecur përpara në këtë fushë.

Këto dhe shumë hallka të tjera do të shpjegohen hap pas hapi nga audit i Albsig tashmë prej më shumë se 3-vitesh përvoja në këtë fushë.

Si filluat punë në Albsig, si ishte kriteri i përzgjedhjes suaj?

Pas përfundimit të studimeve të larta, kam kryer praktikën në Albsig. Fusha e sigurimeve më është dukur tërheqëse që gjatë shkollës së lartë, madje në përfundim të studimeve master kam mbrojtur temën "Tregu i Sigurimeve Jo-Jetë në Shqipëri dhe Risqet e Ndeshura (Tërmetet, Covid-19)". Gjatë praktikës, mendoj se ajo çfarë ka spikatur fillimisht ka qenë dëshira për të mësuar. Jam i mendimit se njeriu mëson dhe duhet të mësojë gjatë gjithë jetës, duhet të jetë konsistent dhe i disiplinuar.

Sa vite pune keni në Shoqëri dhe si u stabilizuat në profilin që ju dispononi si Audit?

Kam 3 vite që jam pjesë e stafit të Albsig dhe jam shumë i kënaqur për mënyrën se si ka rrjedhur gjithçka. Kam qenë me fat që kam punuar me kolegë të aftë dhe me eksperiencë, të cilët kanë qenë të gatshëm të ndajnë me mua njohuritë e tyre. Jam ndjerë i privilegjuar në shumë raste përsa i përket hallkave të profesionit. Më është dashur të lexoj shumë, edhe jashtë orarit të punës, për të hyrë në fushën e auditimit dhe sigurimeve.

Sa e vështirë është për ty të ushtrosh në mënyrë të pavarur funksionin e auditimit pa lënë hapësirë për ndërhyrje nga kolegët, mbikëqyrësit, drejtuesit e njësive së auditimit apo dhe pala e audituar, me përjashtim të marrëdhënieve të ndërsjellta të këshillimit?

Të them të drejtën, kjo ka qenë një nga problemet më të vogla gjatë rrugëtimit tim si auditues. Natyra ime e qetë dhe jo konfliktuale më ka ndihmuar në komunikimin me palët e audituara. Megjithatë, ndonjëherë më është dashur të shpjegoj se auditimi nuk ka qëllim për të "qortuar" askënd, por për t'u siguruar se shoqëria ka vendosur sisteme kontrolli të mjaftueshme, në përputhje me objektivat e saj. Sigurisht që një auditues duhet të ketë objektiva dhe synimi im është të krijoj një mjedis bashkëpunues, në mënyrë që puna të bëhet brenda afatit dhe me cilësi të lartë. Unë jam në fillimet e mia dhe besoj e shpresoj që në një të ardhme të plotësoj siç duhet hallkat e profesionit të audituesit.

Pasi ju keni bërë një periudhë kohe në këtë punë dhe e dini se si veprohet në këtë fushë a e keni të vështirë të siguronit të gjitha të dhënat me karakter teknik, ekonomik, financiar dhe menaxherial të njësive që auditohet, duke marrë përsipër ruajtjen e fshehtësisë së tyre?

Ruajtja e informacioneve konfidenciale është një nga detyrat parësore si auditues, mbi të cilën bazohet edhe besueshmëria dhe reputacioni.

Sigurimi i të dhënave nuk është i vështirë, por përpunimi dhe analizimi i tyre kërkon kujdes, saktësi dhe përpikmëri, pasi puna si auditues nuk lë hapsirë për gabime.

Ka raste që më është dashur të kontrolloj punën time mbi 3 herë për t'u siguruar se është pa gabime.

A është i vështirë auditimi dhe çfarë mendon për të ardhmen që të rritesh profesionalisht në këtë fushë?

Tregjet financiare në Shqipëri vazhdojnë të ndryshojnë çdo vit me shpejtësi dhe si auditues i brendshëm është e domosdoshme që të përshtatem me këto ndryshime dhe të jem i përditësuar. Një nga këshillat më të rëndësishme nga Warren Buffett (investitori më i famshëm në botë dhe një idhull i imi) është: "Lexo 500 faqe çdo ditë... Kështu funksionon dija. Ajo rritet, si interesi i përbërë. Të gjithë kanë mundësinë ta bëjnë, por jo shumë e bëjnë." Gjithmonë më ka pëlqyer leximi dhe mundohem të lexoj gjatë gjithë ditës. Është thelbësore për një auditues që të lexojë, që nga ligjet dhe rregulloret, standardet e auditimit, të kontabilitetit e me radhë. Në fundjavë gjej gjithmonë kohë për të lexuar ndonjë libër. Mendoj se të mësuarit gjatë gjithë kohës është një nga çelësat e suksesit në fushën e auditimit.

Ku e shikoni veten pas një periudhe 5-vjeçare?

Pas 5 vitesh, shoh një version më të mirë të vetes, të përfshirë në përgjegjësi dhe vendimarrje më të mëdha profesionale. Nga ana tjetër, arritja më e madhe profesionale për një auditues të brendshëm është certifikimi si CIA (Certified Internal Auditor). Sa i përket zhvillimit profesional, ky është një nga qëllimet e mia parësore gjatë 5 viteve të ardhshme, ndoshta edhe më shpejt.



Shëndeti në Udhëtim,

Sigurimi që i Duhet Çdo Pushuesi Jashtë Vendi

Keni menduar të udhëtoni për turizëm, punë apo për biznes? Mos harro të kesh me vete "Sigurimin e Shëndetit në Udhëtim". Pajisja me "Sigurimin e Shëndetit në Udhëtim" duhet të jetë një nga gjërat e para që dikush bën sapo rezervon një udhëtim jashtë vendit. Një sigurim i mirë gjatë udhëtimit mund të jetë mbrojtja juaj më e mirë financiare. Në Albsig "Sigurimin e Shëndetit në Udhëtim" është një ndër produktet më efikase, i cili i përgjigjet kërkesave të çdo konsumatori. "Sigurimin e Shëndetit në Udhëtim" çdo konsumator mund ta blejë edhe online me 30% zbritje nga çmimi aktual i tregut. Edhe në sportelet e ndryshme të Albsig, çmimi i shëndetit në udhëtim është shumë efikas dhe i përshtatshëm sidomos për familjet që shkojnë për pushime, për ata që presin dhe sigurimin e Kartanit Jeshil.

A kemi nevojë për sigurim udhëtimi?

Kjo është pyetja pse shumë vende kanë shtuar "Sigurimin e Shëndetit në Udhëtim" si pjesë e kërkesave të tyre për vizë. Por nëse udhëtojmë në një vend ku nuk kërkohen viza, "Sigurimin e Shëndetit në Udhëtim" është zakonisht opsional – kështu që shumë prej nesh priren ta anashkalojnë atë. Anashkalimi dhe mospajisja me "Sigurimin e Shëndetit në Udhëtim", është një problem serioz për gjithësecilin prej nesh, njëkohësisht dhe pasojë shumë e rëndë financiare për çdo familje.

Çfarë mbulohet gjatë kohës së qëndrimit jashtë vendit?

"Sigurimin e Shëndetit në Udhëtim" do t'ju mbulojë sigurimin e shëndetit gjatë qëndrimit tuaj jashtë vendit në rast të ndonjë sëmundje akute si dhe do të mbulojë maksimalisht deri në limitin e sigurimit tuaj. Për disa vende, të cilat ju planifikoni t'i vizitoni, sigurimi i shëndetit është i domosdoshëm, andaj Albsig.sh.a ka ofertën më të mirë për ju dhe familjet tuaja.

Cilat janë shpenzimet dhe kompensimi gjatë shtrimit në spital?

Albsig do të kompensojë për asistencën mjekësore dhe shtrimin në spital si pasojë e sëmundjes akute të rikuperueshme, të përcaktuar sipas policës së sigurimit të përzgjedhur nga vetë i siguruari. Falë bashkëpunimit të madh me kompanitë Evropiane, ne do të kujdesemi deri në fund për mirëqenien tuaj deri në kthimin në atdhe.

Po lidhur me fatkeqësitë jashtë vendit?

Në raste të vdekjes së personit si pasojë e aksidentit gjatë udhëtimit apo sëmundjeve të ashtuquajtura akute, sigurimi ynë mbulon riatdhesimin e kufomës në shtetin rezident.

Çfarë përfshin "Sigurimi i Shëndetit në Udhëtim"?

- Vizita mjekësore urgjente
- Shpenzimet për medikamentet mjekësore
- Trajtime spitalore urgjente
- Riatdhesim

Cilat janë shpenzimet e mbuluara në rast dëmi?

Në rast dëmi shëndetësor, "Sigurimin e Shëndetit në Udhëtim" mbulon:

- Sëmundjet akute
- Aksidentet
- Humbjen e jetës



PJESË E  KASTRATI GROUP



-30%

për blerjet online

Sigurimi Kasko

-10%

për blerjet online



ALBSIG



PJESË E
KASTRATI GROUP



60-Vjeçari: Ja si Mora 30.000 Lekë Gjorbë se Nuk Kisha Sigurim Makine.

“Të lutem dua të bëj sigurimin e makinës sepse jam djegur njëherë”, kështu nis kërkesën e tij për t’u pajisur me sigurimin e detyrueshëm TPL, Ismail Shabani. Ndërkaq është dakortësuar për çmimin dhe ka bërë gati pagesën për ta dorëzuar. Kureshtja për ta sqaruar dhe më tej atë shprehjen që sapo tha më parë na bën që ta pyesim më gjatë. “Unë makinën e kam në emrin e djalit, të rinjtë nuk i shikojnë datat e rinovimeve edhe kanë angazhime në punë.

Unë kisha më shumë se një muaj që më kishte mbaruar siguracioni, bëhet fjalë për para një viti dhe u gjobita me 30.000 lekë gjorbë nga policia”, tregon me detaje ky i fundit. Madje shton se është mëkat i madh për financat e një familje që të marrë një gjorbë të tillë për neglizhencë apo harresë të momentit. “Nuk ja fal vetes që kishte shkuar situata deri në atë shkallë. Po me kohën e pandemisë janë shtuar më shumë problemet familjare e shëndetësore”, vijon së thëni 60-vjeçari i cili tashmë është ndërgjegjësuar dhe nuk fal momentin për asgjë përsa i përket sigurimeve.

Drejtuesit e mjeteve që nuk rinovojnë siguracionin e makinave brenda 30 ditëve do të gjobiten automatikisht. Ky ka qenë drafti me ndërhyrjet në kodin rrugor ku përfshihet edhe ky ndryshim dhe është dorëzuar në muajin Marsi të vitit të shkuar në Kuvend dhe ka nis shqyrtimin e menjëhershëm edhe në Komisionet Parlamentare. Ndërkaq 10.000 deri në 40.000 lekë është gjoba për drejtuesit që nuk paguajnë në kohë policën e sigurimit, teksa risia që propozohet edhe ndëshkimi në mënyrë automatike, një kërkesë e hershme kjo e Shoqërive të Sigurimit. Kjo do të bëhet përmes Qendrës së Informacionit, e cila njofton menjëherë organet për regjistrimin e mjeteve për zbatimin e gjobës, teksa rregullat dhe procedurat për vendosjen e saj do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Sipas draftit, mjetet e reja në 3 vitet e para nuk do të kryejnë kolaudimin, mjetet e përdorura do ta kryejnë atë çdo 2 vjet nga çdo vit që ishte aktualisht, ndërsa taksitë, ambulancat dhe autobusët do të bëjnë kolaudimin një herë në vit, nga çdo 6 muaj që parashikonte ligji aktual. Ndërhyrjet në Kodin Rrugor parashikojnë ashpërsim të masave për shkeljet nga drejtuesit e mjeteve që ngasin makinën nën efektin e alkoolit, përdorin celularin apo udhëtojnë mbi shpejtësinë e lejuar.

Propozimet përfshijnë përshkallëzim të gjobave e deri në heqje të lejes së drejtimit të mjeteve në rast përsëritje të shkeljeve të mësipërme. Ndër të tjera, drafti parashikon rritje të gjobave edhe për mosvënien të rripit nga shoferi nga 5.000 deri në 15.000 lekë si dhe nga 1.000 deri në 3.000 lekë në rast se nuk e ka vendosur pasagjeri. Ashpërsimi i masave propozohet edhe për drejtuesit e mjeteve që udhëtojnë me makina të blinduara, që në rast mospajisje me autorizim, gjobiten nga 100.000 deri në 200.000 mijë lekë apo edhe konfiskim të mjetit.

Ndërhyrje parashikohen edhe në sistemin e pikëzimit të lejeve të drejtimit, pasi me humbjen totale të pikëve, mbajtësi i patentës duhet të ndjekë një kurs pranë autoshkollave të licencuara e më pas t’i nënshtrohet provimit të kualifikimit.

Partneriteti i shoqërisë Albsig Jetë me MediGuide MSO sjell tashmë shërbimin e opinioneve të dyta mjekësore prej të cilit po përfitojnë miliona njerëz në më shumë se 60 vende të botës. Për shoqërinë Albsig Jetë, partneriteti me një kompani si Mediguide MSO me një përvojë mbi 20 vjeçare dhe shtrirje globale, është jo vetëm një hap i madh në tregun e sigurimeve, por një tregues tepër domethënës i aftësisë së kësaj shoqërie për të identifikuar nevojën për një shërbim që për shqiptarët ka qenë gjithmonë shumë i vështirë, i kushtueshëm, apo i pamundur. Tashmë, kushdo mund të pajiset me kartën MediGuide MSO dhe MSO Plus për të përfituar opinionin e dytë mjekësor të mjekëve specialistë më të mirë në të gjithë botën dhe për të garantuar diagnostikimin e saktë dhe trajtimin e duhur për çdo sëmundje.

MediGuide International LLC, me qendër në Delaware të Shteteve të Bashkuara të Amerikës është kompania lider në botë për ofrimin e shërbimit MSO (Opinionet e Dyta Mjekësore). Kompania është themeluar në vitin 1999 dhe që atëherë, ka shtrirë veprimtarinë e saj në pesë kontinente, duke pasur klientë në më shumë se 60 shtete dhe duke menaxhuar rastet e opinioneve të dyta mjekësore në qendra të specializuara të më shumë se 152 vendeve në botë. Misioni i Mediguide ka qenë dhe mbetet mundësimi i zgjidhjeve shëndetësore pa kufizime ekonomike dhe gjeografike, nëpërmjet aksesit në informacionin më të mirë mjekësor.

Procedura e marrjes së opinionit të dytë mjekësor nëpërmjet MediGuide është mjaft e thjeshtë dhe nuk përfshin asnjë kosto shtesë. Të pajisurit me Kartën MediGuide do të mund të lidhen me koordinatorin e MediGuide me anë të një telefonate dhe do të marrin orientimet e nevojshme për gjithë procesin. Koordinatori do t'ju ofrojë të drejtën e zgjedhjes mes tri qendrave mjekësore të përzgjedhura me kujdes për të shqyrtuar kartelën dhe pasi të bëhet zgjedhja, kartela shqyrtohet nga një ekip shumëdisiplinor specialistësh. Pacienti do të marrë raportin e plotë të opinionit të dytë mjekësor për rastin e tij brenda dhjetë ditëve nga data e kërkesës dhe më pas mund të diskutojë rezultatet me MediGuide dhe mjekun e tij personal. Ky shërbim ofron gjithashtu edhe mundësimin e bisedave mes specialistëve të MediGuide dhe mjekut personal në rast se lind nevoja e ndryshimit të trajtimit mjekësor.

Albsig Jetë e sjell këtë shërbim me anë të dy paketave: MSO dhe MSO Plus, të cilat, që prej muajit Qershor janë bërë të vlefshme për të gjithë ata që duan të marrin diagnoza të sakta dhe trajtimet e duhura mjekësore me më pak ndërlikime, duke pasur mundësi të shmangin analizat dhe ekzaminimet e përsëritura, apo ndërhyrjet e kushtueshme kirurgjikale. Paketa MSO përfshin rishikimin e plotë të diagnozës origjinale dhe një plan trajtimi të propozuar nga specialistët e qendrës mjekësore lider në botë të zgjedhur nga vetë mbajtësi i kartës. Paketa MSO Plus, përveç opinionit të dytë mjekësor, ofron edhe shërbimin e asistencës mjekësore rajonale dhe shërbim për kontrollin e kostos së kujdesit shëndetësor. Nëpërmjet këtij shërbimi, mbajtësi i kartës MediGuide do të referohet në një qendër mjekësore të rajonit të zgjedhur nga vetë ai, do të marrë një vlerësim të kostos sipas trajtimit të propozuar, si dhe do të ketë lehtësira në transport dhe akomodim. Paketat MSO dhe MSO Plus janë të vlefshme si për individë, ashtu edhe për familje dhe garantojnë që diagnoza dhe trajtimi i sëmundjes të jenë në duart e mjekëve më të mirë dhe të qendrave lider të kujdesit shëndetësor në botë.

Albsig Jetë sh.a., pjesë e Grupit KASTRATI, është Shoqëri Aksionare me seli në Rrugën e "Barrikadave" në Tiranë, e cila ofron sigurimin e jetës për të gjitha kategoritë që prej vitit 2019 dhe është një nga kompanitë me trendin më të lartë të rritjes në tregun e sigurimeve. Partneriteti me MediGuide MSO bën pjesë në strategjinë e suksesshme të ndjekur nga shoqëria Albsig Jetë, që krahas produkteve tradicionale të sigurimit të jetës, të sjellë dhe produkte të reja inovative që plotësojnë nevojat e tregut, por edhe atë të qytetarëve shqiptarë për një cilësi më të mirë jetese dhe përfitim të shërbimeve më cilësore.

Nëse dëshironi të merrni më shumë informacion mbi pajisjen me kartën MediGuide dhe paketat MSO dhe MSO Plus, mund të vizitoni faqen zyrtare <https://www.albsig-jete.al/mediguide/>, apo të kontaktoni në numrin 8001503, i cili është linjë e dedikuar 24/7 me shërbim telefonik falas.

Albsig Jetë sjell shërbimin e Opinionit të Dytë Mjekësor me kartën MediGuide



Një Partner
me Përvojë
në Anën Tuaj!



☎ +355 (0) 42254770 / 764

✉ info@albsig.al

WWW.ALBSIG.AL